

**SHPALLJE POZICIONE VAKANTE ME KONTRATE TE PERKOHSHME SEZONALE PER  
VITIN 2024**

Në zbatim të Ligjit Nr. 10109, datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë” dhe të VKM-së nr. 39, datë 24.01.2024, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024 në njësitë e qeverisjes qendrore”; Drejtoria e Pergjithshme Detare;

- **Shpall 12 (dymbëdhjete) vende vakant për pozicionin “Specialist Kapitenerie”, me kontratë të përkohshme (Prill-Shtator)**, në mbështetje të VKM-së nr39, datë 24.01.2024, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024 në njësitë e qeverisjes qendrore”; (Prill-Shtator)

**KËRKESAT E POSACME TË POZICIONIT PËR “SPECIALIST KAPITENERIE”, ME  
KONTRATË TË PËRKOHSHME:**

**Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Navigacion/ Inxhinjeri Navale.
- Preferohen të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.
- Preferohen të kenë trajnime në fushën e detarise

Marrëdhënia e punës me Drejtorinë e Pergjithshme Detare për këto pozicione rregullohet nga dispozitat e ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe në mbështetje të VKM-së nr. 39, datë 24.01.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024 në njësitë e qeverisjes qendrore”. Kategoria e pagës për pozicionin e “Specialist Kapitenerie”, është “Kategoria IV-b.

<b>KAPITETENERITE</b>	<b>Nr. i Punonjësve 2024</b>	<b>Emërtesa</b>	<b>Koha mesatare ditore</b>	<b>Periudhë kohore</b>
Kapiteneria e porti Vlore, Petrolifera, terminali mjeteve turistike	3	Specialist Kapitenerie	8 orë/ditë	Prill-Shtator
Kapiteneria e porti Himare	2	Specialist Kapitenerie	8 orë/ditë	Prill-Shtator
Kapiteneria e porti Sarande, Limion	3	Specialist Kapitenerie	8 orë/ditë	Prill-Shtator
Kapiteneria e Portit Shengjin, Koman, Liqeni Shkodres	2	Specialist Kapitenerie	8 orë/ditë	Prill-Shtator
Kapiteneria e Porti Dures Liqeni Pogradecit	2	Specialist Kapitenerie	8 orë/ditë	Prill-Shtator

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton pozicionin, për të cilin është i interesuar të aplikojë.

Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune). Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal ose Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
4. Dokument që vërteton eksperiencën në fushën profesionale
5. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet brenda datës 25 Mars 2024 pranë Drejtorisë së Pergjithshme Detare në adresën: Rruga Tregtare, Lagja nr.1, Durrës, Zyra e Protokollit ose online në email: [info@dpdetare.gov.al](mailto:info@dpdetare.gov.al).**